



MLSP
MINISTRY OF LABOUR
AND SOCIAL POLICY



**SEKTORI PËR
MUNDËSI TË BARABARTA**

KUSH JEMI NE



Sektori për mundësi të barabarta pranë Ministrisë për punë dhe politikës sociale është themeluar në vitin 2007 dhe në të funksionojnë Sektori për barazi gjinore dhe Sektori për parandalimin dhe mbrojtjen nga çfarë do qoftë lloji të dhunës dhe nga

diskriminimi. Themelimi i Sektorit do të thotë ngritje të statusit dhe të mandatit të Seksionit për përparimin e barazisë gjinore, e cila u themelua në vitin 1997 me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Sektori për mundësi të barabarta kujdeset për përparimin e statusit të grave dhe të burrave në të gjitha lëmit të jetës shoqërore dhe vendosje të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, në nivel kombëtar dhe lokal. Në nivel kombëtar, lokal dhe ndërkombëtar. Këto kompetenca Sektori i realizon përmes bashkëpunimit me institucionet e shtetit, si dhe në bashkëpunim me sektorin civil dhe me partnerët social. Poashtu Sektori është përgjegjës për zbatimin e rregullativës pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë, Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave dhe Planin Kombëtar për aksion të barazisë gjinore. Parandalimi dhe mbrojtja nga çfarë do lloji të dhunës dhe të diskriminimit paraqesin pjesë të aktiviteteve të Sektorit.

- Në vitin 1999 Qeveria e miratoi planin Kombëtar për aksion për barazinë gjinore.
- Në vitin 2005 është themeluar Komisioni Kombëtar për udhëzim të viktimave të trafikimit me njerëz.
- Në vitin 2006 është miratuar Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave, me çka filloi procesi i krijimit të mekanizmave për vendosjen e mundësive të barabarta të grave dhe të burrave në nivel qendror dhe lokal.
- Janë bërë edhe ndryshime në ligjet zgjedhore, përmes të cilave është mundësuar rritja e numrit të grave të përfaqësuara në Parlamentin dhe në vetëqeverisjen lokale.
- Është miratuar plani i dytë Kombëtar për aksion për barazinë gjinore 2007-2012.
- Është themeluar Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.



- Janë emëruar koordinatorët për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave në ministritë dhe në vetëqeverisjet lokale
- Është miratuar Programi për re-socializim dhe re-integrim të fëmijëve viktime të trafikimit me njerëz.
- Është përparuar rregullativa ligjore për mbrojtjen e viktimave nga trafikimi me njerëz.
- Në vitin 2003 Maqedonia ishte nikoqire e konferencës ministrore të Këshillit të Evropës për barazi gjinore në temën “Roli i barazisë gjinore në ruajtjen e paqes dhe zgjidhjen paqësore të konflikteve”
- Në shtator të vitit 2007 në Shkup u mbajt seminar Regjional në kuadër të fushatës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna mbi gratë, përfshirë aty edhe dhunën në familje.
- Nga viti 1997 deri tani Sektori ka realizuar më shumë projekte, trajnime dhe seminare për barazi gjinore, mbrojtje nga diskriminimi dhe luftë kundër trafikimit të njerëzve.

Në pajtim me nenin 23 të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave, në Sektorin është punësuar përfaqësues juridik për përcaktimin e trajtimit jo të barabartë të grave dhe të burrave. Në pajtim me dispozitat e Ligjit, përfaqësuesi juridik do të bashkëpunojë me subjektet kompetente (organet e inspektimit, avokatin e popullit ose organ tjetër kompetent).

DOKUMENTE NDËRKOMBËTARE

- Deklarata Universale për të drejtat e njeriut
- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave
- Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut
- Konventa për luftë kundër trafikimit me njerëz dhe krimit të organizuar trans nacional dhe Protokollit të Palermos
- Konventa Evropiane e Këshillit të Evropës për luftë kundër trafikimit me njerëz



“BARAZIA GJINORE NË PROCESIN ARSIMOR: ARSIMI I SENZIBILIZUAR NË LIDHJE ME GJINITË”

equalitarian /ɪˌkwɒlɪˈtɜːrɪən/

EGALITARIAN.

– DERIVATIVES

equality ● n.

symbolic expression of the fact that all are equal; an equation.

Në vitin 2008 Sektori për barazi gjinore në Bashkëpunim me Ministrinë e arsimit dhe të shkencës e realizoi Programin për arsim të sensibilizuar të dedikuar për kuadrin arsimor nga shkollat fillore prej klasës së parë deri të pestën.

Qëllimi i këtij programi ishte që përmes trajnimeve të mundësohet përfitimi i shkathtësive dhe të diturive për kuadrin

arsimor nga arsimi fillor për konceptet nisëse për zhvillimin gjinor dhe për inkorporimin e konceptit gjinor në programet dhe në planet arsimore.

Më Programin u përfshinë të gjitha shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë. U realizuan 15 trajnime në të cilat morën pjesë 330 arsimtarë klasor.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

neni 9

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhjes kombëtare ose sociale, bindjes politike ose fetare, pozitës pronësore dhe shoqërore.

Barazia midis grave dhe burrave konsiderohet si çështje e të drejtave të njeriut dhe parakusht dhe indikator për zhvillim të qëndrueshëm të njeriut në tërësi.

DEKLARATË – TA BËJMË BËJMË REALITET BARAZINË GJINORE

(Miratuar nga Komiteti i ministrave të Këshillit të Evropës 12 maj i vitit 2009, në seancën e 119-të - Madrid)

...Duke u rikujtuar se barazia gjinore do të thotë dukshmëri, emancipim, përgjegjësi dhe pjesëmarrje të njëjtë në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Barazia gjinore është një gjë e kundërt nga dallimet gjinore;

Duke u rikujtuar se politikat do të jenë të sensibilizuara sa u përket gjinive dhe se ato do të duhej ta kenë parasysh realitetin social me të cilin janë në relacion, duke e pasur parasysh se shoqëria është e përbërë nga gra dhe burra të cilat mund të kenë nevoja të ndryshme...



PËRKRAHJE E KOMISIONEVE PËR MUNDËSI TË BARABARTA PËR GRATË DHE BURRAT NË NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE

Sektori për mundësi të barabarta pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale në bashkëpunim me zyrën e UNDP-së realizon projekt që është i ndërlidhur me konceptin gjinor në politikat lokale.

Projekti ka për qëllim përforcimin e kapaciteteve të komisioneve për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave pranë këshillave të njësive të vetëqeverisjes lokale, si element kyç i cili kontribuon për realizimin e politikës së barazisë gjinore në nivel lokal. Përmes sigurimit të ndihmës teknike dhe trajnimit të makinerisë për barazi gjinore në nivel lokal, do të kontribuohet për qartësimin e mëtejshëm dhe për zbatimin në praktikë të kompetencave të këtyre komisioneve, do të sforcohet kapaciteti i tyre dhe autoriteti për koordinim efikas dhe efektiv të politikave

të barazisë gjinore. Pritet që projekti ta përmirësojë të kuptuarin dhe zbatimin në praktikë të koncepteve të barazisë gjinore dhe të “mejnstimmingut” gjinor (vënien e barazisë gjinore në rrjedhat kryesore shoqërore) në përgatitjen e politikave lokale.

Me projektin janë përfshirë të gjitha komunitat në Republikën e Maqedonisë. Janë paraparë trajnime për të gjithë koordinatorët për mundësi të barabarta, si dhe për anëtarët përkatësisht këshilltarët nga komisionet për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave dhe të palëve tjera të interesuara për përgatitjen e planeve aksionare për barazi gjinore në çdo vetëqeverisje lokale. Poashtu, fokusi do të orientohet drejt përpilimit të internet portalit për “mejnstimming” gjinor si



vegël për bashkëpunim në rrjet edhe në nivel horizontal edhe në atë vertikal dhe këmbimi i përvojave midis Sektorit për mundësi të barabarta pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale, njësitë e vetë qeverisjes lokale dhe komisioneve për mundësi të barabarta të grave dhe të burrave pranë vetëqeverisjeve lokale.

Vënia e konceptit gjinor në punën e vetëqeverisjes lokale, paraqet implementim, para së gjithash, të Ligjit Kombëtar aksionar për barazi gjinore, nga të gjithë subjektet e ngarkuar për promovimin dhe përparimin e barazisë gjinore në nivel lokal dhe kombëtar.

www.rodovaramnopravnost.gov.mk

BUXHETIMI SENZITIV GJINOR



Vegla “Buxhetimi gjinor” është njëri nga shembujt praktik për arritjen e barazisë gjinore, ndërsa Republika e Maqedonisë është shteti i parë në regjionin i cili zbaton aktivitete të ndërlidhura me këtë problematikë në nivel kombëtar. Sektori për mundësi të barabarta pranë Ministrisë të punës dhe politikës sociale realizon program njëvjeçar të orientuar drejt

ballafaqimit me varfërinë dhe papunësisë përmes analizës gjinore të politikave buxhetore, i përkrahur nga UNIFEM dhe Agjencia Austriake për zhvillim. Çështja e barazisë dhe e inkuadrimit të perspektivave gjinore në rrjedhat kryesore nuk është çështje vetëm e drejtësisë sociale, por është çështje tejet e rëndësishme në ballafaqimin me varfërinë dhe me papunësinë, sigurimin e mundësive të barabarta dhe të jetës cilësore për të gjithë. Për këto shkaqe është e nevojshme të konstatohet se arritja e barazisë më të madhe gjinore dhe kacafytja me mos barazitë ekzistuese shumë shpesh do të thotë që të punohet në mënyrë të ndryshme me gratë dhe me burrat, që të shihen pengesat e ndryshme me të cilat ata ballafaqohen, por edhe nevojat, prioritetet dhe aspiratat e ndryshme.

TRAJNIM PËR VENDOSJEN E KONCEPTIT GJINOR NË PUNËN E PUNËTORËVE SOCIAL, POLICISË DHE PUNËTORËVE SOCIAL



Vendosja e konceptit gjinor në punën e punëtorëve social, policinë dhe të punëtorëve shëndetësor dhe sensibilizimi gjinor i këtyre shërbimeve profesionale është e theksuar në një numër të madh të raporteve dhe të rekomandimeve nga institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare (rekomandimet që janë marrë pas mbrojtjes së CEDAW Komitetit pranë OKB-së).

Problemet të cilat këto shërbime profesionale i trajtojnë janë drejt për së drejti në korrelacion me përparimin e barazisë gjinore dhe

mundësitë e barabarta të grave dhe të burrave. Përmes trajnimeve, pjesëmarrësit përfituan dituri dhe informacione për konceptin e Gjinisë dhe zhvillimin (Gender and Development), përfshirjen e perspektivës gjinore në rrjedhat kryesore shoqërore (Gender mainstreaming), informacione për rregullativën ekzistuese ndërkombëtare dhe vendore, me qëllim të krijimit të njohurive për mënyrat e kyçjes së perspektivës gjinore në të gjitha iniciativat e bashkësive, duke i marrë parasysh nevojat e ndryshme të burrave dhe të grave.

TRAFIKIMI ME NJERËZ

Trafikimi me njerëz është forma më e vështirë e shkeljes së të drejtave të njeriut. Çdo vit, mijëra burra, gra dhe fëmijë janë viktime të trafikimit me njerëz në shtetet ose jashtë shteteve të tyre. Pothuajse në çdo vend të botës ka tregti me njerëz. Ky fenomen ka ndikim të fuqishëm negativ posaçërisht mbi shtetet të cilat janë në proces të tranzicionit politik dhe ekonomik ose në periudhë post konfliktuozë.

Njëra nga detyrat e Sektorit për mundësi të barabarta pranë Ministrisë së punës dhe politikës sociale është lufta kundër trafikimit me njerëz. Parandalimi dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit me gra dhe fëmijë është qëllimi i katërt strategjik në “Gratë dhe dhuna” – lëmi i shtatë Strategjik për veprim nga “Plani Kombëtar nacional për barazi gjinore në vitet 2007-2012”.

Në pajtim me interesat dhe përpjekjet për aktivitete të përbashkëta të orientuara drejt çrrënjosjes së trafikimit me njerëz dhe të migrimit jolegal, Ministria e punës

dhe e politikës sociale (MPPS) i intensifikoi, përsosi dhe zgjeroi masat dhe aktivitetet për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit me njerëz, posaçërisht të grave dhe të fëmijëve.

Në Sektorin për mundësi të barabarta pranë Ministrisë në vitin 2005 u themelua mekanizmi Kombëtar për udhëzim (MKU) të viktimave të trafikimit me njerëz. Qëllimi kryesor i këtij mekanizmi është që ta përforcojë aftësinë e shtetit për sigurimin e identifikimit përkatës, ndihmës dhe të mbrojtjes – në sajë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut – për të gjithë viktimat e trafikimit me njerëz, posaçërisht të të miturve, pa marrë parasysh shtetësinë e tyre, përkatësinë etnike, moshën ose seksin. Me rëndësi të posaçme për luftën kundër trafikimit të njerëzve është bashkëpunimi dhe koordinimi midis institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare të cilat merren me këtë problem. Gjatë dy viteve të fundit, Republika e Maqedonisë është vlerësuar me notë më të lartë nga Departamenti amerikan i shtetit,

si vend i cili i përmbush standardet në luftën kundër trafikimit me njerëz.

MKU vazhdimisht e përmirëson procesin ekzistues të identifikimit të viktimave të trafikimit me njerëz, përmes ndërlidhjes me të gjithë partnerët relevant për të siguruar sistemi i udhëzimit të viktimave pa mangësi dhe zbrazëtira.

Partnerë kryesor në luftën kundër trafikimit me njerëz janë Komisioni Kombëtar për luftë kundër trafikimit me njerëz dhe migrim jolegal (përfshirë aty edhe Nëngrupin për luftë kundër trafikimit me fëmijë), Ministria e punëve të brendshme, Ministria e punëve të jashtme, qendrat për punë sociale, Prokuroria publike, institucionet lokale, rrjeti joformal i organizatave joqeveritare të punëtorëve social në Republikën e Maqedonisë.

ËSHTË E THJESHTË...



Ministria për punë dhe politikë sociale, përmes zyrës së MKU me përkrahjen e OSBE-së realizoi fushatë mediave për ngritjen e vetëdijes publike për rreziqet nga trafikimi me njerëz nën moton “Është thjeshtë...” Në fokusin e fushatës, ishin të gjithë qytetarët me theks të veçantë tek të rinjtë, grupet e lëndueshme si nënat vetë ushqyese, viktimat e dhunës familjare dhe personat e pa siguruar sa i përket anës materiale, dhe mjediset rurale.

Fushata përfshiu përgatitje dhe shpërndarje të materialit të printuar, posterë, pamflete, fanella me mëngë të shkurtra, etiketa dhe kalendarë. Janë ngjitur materiale promovuese nëpër kafenetë dhe baret me përmbajtje me tekst që tërheq vërejtjen. U përgatit spot televiziv i cili u shfaq në TV stacionet kombëtare dhe lokale.

TRAJNIME PËR LUFTË KUNDËR TRAFIKIMIT ME NJERËZ



Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të inspektorëve të punës dhe të punëtorëve social për identifikimin e trafikimit me njerëz me qëllim të eksplotimit punues., Ministria e punës dhe politikës sociale në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të punës dhe Misionin e OSBE-së në Shkup realizojnë trajnim gjithëpërfshirës për teknika të

identifikimit të rasteve të trafikimit me njerëz me qëllim të eksplotimit punues.

Në vitet e kaluara janë organizuar një seria trajnime, seminare dhe aktivitete tjera me të vetmin qëllim të ngritjes së vetëdijes publike të qytetarëve në luftën kundër trafikimit me njerëz.


MBROJTJE DHE PARANDALIMI NGA DISKRIMINIMI

Analiza e gjendjeve të ndërlidhura me anti diskriminimin në Maqedoni, e shfaq nevojën për sjelljen e ligjit të veçantë për mbrojtje nga diskriminimi.

Spektori për mundësi të barabarta në vitin 2008 në drejtim të përpilimit të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi në sajë të seksit, orientimit seksual, moshës, përkatësisë etnike, racës, ndaj personave me

invaliditet dhe diskriminimit të dyfishtë, filloi aktivitete për promovimin e standardeve evropiane për respektimin e të drejtave dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të cilët janë viktima potenciale të diskriminimit në sajë të bazave të theksuara më lartë. Për këtë qëllim u organizuan debate publike në nivel lokal.









Ministria e punës dhe e politikës sociale

Spektori për mundësi të barabarta

Dame Gruev numër 14, 1000 Shkup

Tel/faksi 02/3129308

www.mtsp.gov.mk

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale shpreh mirënjohje Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) për ndihmën teknike dhe financiare për përgatitjen e këtij publikimi.



MLSP
MINISTRY OF LABOUR
AND SOCIAL POLICY

Ministria e punës dhe e politikës sociale
Spektori për mundësi të barabarta
Dame Gruev numër 14, 1000 Shkup
Tel/faksi 02/3129308
www.mtsp.gov.mk